VENDIM
Nr.1650, datë 24.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR TRI PROCEDURA PROKURIMI, TË KRYERA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE, SI AUTORITET KONTRAKTUES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të shtyjë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 31 dhjetor 2008, për tri procedura prokurimi, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Agjencia e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR TË CILAT KËRKOHET SHTYRJE AFATI

Nr.	Emërtimi i objektit prokurimit	Forma e prokurimit
1.	**Studimi, projektimi, rishikimi i projektit tri urat Leskovik (neg. pa shpallje)**	**Shkresor**
2.	**Stud. projektim ndërt. ura e Drinit në aksin Kalimash-Kukës (neg. pa shpallje)**	**Shkresor**
3.	**Shërbim me roje civile (BeHaSe, godina e DPRR) (neg. pa shpallje)**	**Shkresor**